



*Universiteti Kombëtar
dhe Kapodistrian i Athinës
Broshurë*



HELLENIC REPUBLIC

National and Kapodistrian
University of Athens

EST. 1837

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| <i>Vizioni</i> | 3 |
| <i>Misioni dhe Politika e Fondacionit</i> | 3 |
| <i>Objektivat strategjike</i> | 4 |
| <i>Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës (EKPA) me një vështrim</i> | 4 |
| <i>Struktura administrative dhe akademike</i> | 7 |
| <i>Vështrimi Historik</i> | 12 |
| <i>Arsimi, Objektet dhe Shërbimet</i> | 19 |
| <i>Marrëdhëniet publike (brenda vendit) dhe ndërkombëtare</i> | 34 |
| <i>Hulumtimi dhe Inovacioni (Risitë)</i> | 39 |
| <i>Mishërimi (Epitoma)</i> | 45 |

Vizioni

Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës (shkurtesa: EKPA) synon në edukimin e shëndoshë në të gjitha nivelet e studimit dhe promovimin e shkencës përmes kërkimit bazë dhe të aplikuar në një gamë të gjerë disiplinash. Vizioni ynë është promovimi i përsosmërisë në fushën e arsimit, inovacioni në kërkime, kultivimi i arsimit në përgjithësi, si dhe pjesëmarrja aktive e komunitetit akademik në aktivitetet sociale dhe kulturore të vendit.

Misioni dhe Politika e Fondacionit

Misioni i Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës gjatë gjithë rrjedhës historike të krijimit të tij gati që nga themelimi i shtetit të ri grek, është përmirësimi i vazhdueshëm i trajnimit të shkencëtarëve të rinj nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të procesit të të mësuarit dhe rinovimit të kurrikulave, kultivimi i frymës së diskursit dhe lidhja efektive e Universitetit me shoqërinë dhe ekonominë. Në përgjigje të zhvillimeve të vazhdueshme të shekullit të 21 në fushën kërkimore dëshirojmë që profesorët, studiuesit dhe studentët tanë brenda departamenteve, laboratorëve dhe klinikave të kërkojnë risi dhe promovim njohurish. Kërkojmë të forcojmë dhe t'i ringjallim çdo anëtar të komunitetit akademik aftësinë dhe pasionin për përparim dhe prosperitet si dhe frymën e ekipit brenda dhe jashtë komunitetit të EKPA-s.

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik, të lirë nga çdo formë e diskriminimit racor (fisnor, prejardhjeje etnike, gjinie, feje, etj) kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime në lidhje me mundësinë në njohuri, në shërbimet dhe mjediset e EKPA-s, sipas politikave të Universitetit, të ligjit grek dhe të së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare.

Qëllimet strategjike

Historia e EKPA-s dhe burimet njerëzore janë shtyllat kryesore të zhvillimit të Universitetit tonë të cilat caktojnë akset që përcaktojnë objektivat strategjike të Fondacionit, nën vizionin dhe misionin e tij. Objektivat e saj strategjike janë të mirëorientuara në mënyrë që të vendosin dhe të vazhdojnë traditën për t'u përtërir dhe shquar në Greqi dhe jashtë vendit, në të gjitha nivelet: në arsim, kërkime dhe kulturë, duke siguruar që EKPA-s të vazhdojë të ndikojë në jetën publike dhe të hartojë zhvillimin politik. Për këtë arsye, promovohet çdo bashkëpunim që kontribuon në arritjen e misionit dhe të vizionit të Universitetit tonë me institucione dhe organizata të shquara në fushën e tyre.

Qëllimi kryesor i EKPA-s është tërheqja e studentëve- kandidatëve më të mirë, por edhe e Profesorëve nga universitete të shquara jashtë vendit. Shqetësimi ynë mbetet që EKPA-s të përmirësojë vazhdimisht njohje të rëndësishme ndërkombëtare në listat e rangut universitar global, studentët tanë të dallohen në konkurrime ndërkombëtare dhe tendere shkencore dhe të diplomuarit tanë të gëzojnë njohje akademike dhe profesionale si në vendin tonë ashtu edhe jashtë vendit. Gjithashtu, qëllimi ynë është shfrytëzimi nga shoqëria dhe institucionet produktive rezultatet e hulumtimeve të kryera në universitetin tonë. Në lidhje me promovimin dhe publicitetin e arritjeve të punës (akademike, kërkimore, zhvillimore, sociale, kulturore) të kryera nga çdo anëtar i komunitetit tonë akademik, ne fokusohemi në përhapjen e tyre sa në komunitetin akademik ndërkombëtar aq edhe në shoqëri e në institucionet shtetërore, nga njëra anë promovimin e një politike të qasjes së hapur, dhe shfaqjen e ofertës së rëndësishme dhe shumëdimensionale të EKPA-s nga ana tjetër.

EKPA me një shikim. Historia dhe statusi operativ

Universiteti i Athinës u themelua në vitin 1837 me emrin fillestar “Universiteti Othonios”. Ishte Universiteti i parë jo vetëm i shtetit grek, por edhe i gjithë Gadishullit Ballkanik dhe rajonit më të gjerë të Mesdheut Lindor. Në vitin 1932 ai u emërua “Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës”, emër të cilin e mban deri më sot. EKPA-s është një entitet publik, plotësisht vetë-qeverisës, i cili është subjekt i rregullave të së drejtës publike dhe mbikëqyret nga Ministria e Arsimit, Kërkimit dhe Çështjeve Fetare.

Fakultete, Departamente dhe Mjedise

- Fakultete: 8
- Departamente: 33
 - Numri i programeve universitare: 33
 - Numri i programeve pasuniversitare: 136
- Institute të Kërkimeve Universitare (EPI): 5
- Spitale Universitare: 2
- Klinika Universitare: 76 (nga të cilat 60 janë në Fakultetin e Mjekësisë, 11 në Fakultetin e Infermierisë dhe 5 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare /Stomatologjisë)
- Labororë: 210, nga të cilët 169 të legjitimuara me Gazetën e Qeverisë dhe 41 nga vendimet e Departamentit / Senatit
- Biblioteka: 8
- Muzeume: *Muzeu i Historisë së Universitetit të Athinës, 13 muzeume tematike që i përkasin disa Fakulteteve ose / dhe Departamenteve dhe Arkivit Historik të Universitetit.*

Burime njerëzore:

- Profesorë, lektorë , personel tjetër mësimor: 2.104
 - Personeli administrativ: 1.087
- (stafi i përgjithshëm: 3.191)

Studentë:

- Numri i studentëve (aktivë): 39.088
- Numri i studentëve pasuniversitarë (Master): 11,479
- Numri i kandidatëve: 14.240
- Studentët e huaj që studiojnë në EKPA: 5.654



Struktura administrative dhe akademike e Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës

I. AUTORITETET KRYESORE

REKTOR

Profesor Meletios-Athanasios Dhimolupos
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9770, 210 368 9771
Fax: 210 368 9717
e-mail: rector@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Profesor Napoleon Maraveia
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9776
Fax: 210 368 9682
e-mail: vrec-admin@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ÇËSHTJEN E ZHVILLIMIT POLITIK DHE HULUMTIMIT

Profesor Thomas Sfikopulos
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9772
Fax: 210 368 9711
e-mail: vrec-rd@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ZBATIMIN E ÇËSHTJEVE AKADEMIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE

Profesor Konstantinos Burazelis
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9766
Faksi: 210 368 9691
e-mail: vrec-acafir@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE

Profesor Nikolaos Milonas
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9760
Fax: 210 368 9711
e-mail: vrec-fin@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ÇËSHTJET E MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT

Profesor Georgios Polimenas
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9779
Fax: 210 368 9741
e-mail: vrec-students@uoa.gr

ZËVENDËSREKTOR PËR ÇËSHTJET E SHENDETËSISË DHE POLITIKAVE SOCIALE

Profesor George Zografos
Panepistimiu 30, 10679 Athinë
Tel: 210 368 9773
Fax: 210 368 9741
e-mail: vrec-hospitalsgz@uoa.gr

II.KËSHILLI I INSTITUCIONIT

PRESIDENT

Profesor i Universitetit të Harvardit, George Tsokos
Tel: 210 368 9724/9744
Fax: 210 368 9700
e-mail: council@uoa.gr

III.SENATI

Senati përbëhet nga Rektori, Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Departamenteve, deri në dy për çdo Fakultet me një afat dyvjeçar jo të përtërirë dhe alternim në secilin Fakultet derisa të gjitha Departamentet e Fakulteteve të jenë përfshirë. Në mbledhjet e Senatit, Zëvendësrektorët marrin pjesë, pa të drejtë vote.

IV. STRUKTURA E FAKULTETEVE DHE E DEPARTAMENTEVE

Tetë (8) Fakultetet dhe tridhjetë e tre (33) Departamentet e listuara që u përkasin atyre, si dhe Dekanët dhe Përgjegjësit e tyre.

FAKULTETI TEOLOGIK (<http://deantheol.uoa.gr/>)

Dekan: Profesor Apostolos Nikolaidis

Departamenti i Teologjisë (<http://www.theol.uoa.gr/>) - President: Profesor i asociuar Thomas Ioannidis

Departamenti i Teologjisë Sociale (<http://www.soctheol.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Sotirios Despotis

FAKULTETI JURIDIK (<http://www.law.uoa.gr/>)

Dekane: Profesore Dionisia Kallinikou

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE POLITIKE (<http://deaneconpol.uoa.gr/>)

Dekan: Profesor Mihail Spourdhalakis

Departamenti i Shkencave Politike dhe Administratës Publike (<http://www.pspa.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Hristos Lirintzis

Departamenti i Ekonomisë (<http://www.econ.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Nikolaos Ireiotis

Departamenti i Komunikimit dhe Masediave (<http://www.media.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Dimitrios-Stamatios Haralambis

Departamenti i Studimeve Turke dhe Studimeve Bashkëkohore Aziatike (<http://www.turkmas.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Ioannis Mazis

FAKULTETI FILOZOFIK (<http://www.deanphil.uoa.gr/>)

Dekane: Profesore Eleni Karamalegou

Departamenti i Filologjisë (<http://www.phil.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Amfilohios Papatomas

Departamenti i Historisë dhe Arkeologjisë (<http://www.arch.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Panajiotis Valavanis

Departamenti i Filozofisë, Pedagogjisë dhe Psikologjisë (<http://www.ppp.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Maria-Zoi Funtopulu

Departamenti i Psikologjisë (<http://www.psych.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Hrisi Hadxihristou

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze (<http://www.enl.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Evangelia Sakeliu - Schultz

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Franceze (<http://www.frl.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Maria Papadhima

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane (<http://www.gs.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Anastasia Antonopulu

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Italiane (<http://www.ill.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Georgios Mikros

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Spanjolle (<http://www.spanll.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Dhimitrios Dhrosos

Departamenti i Studimeve Muzikore

Përgjegjës: Profesor Ahileas Haldheakis

Departamenti i Studimeve të Teatrit

Përgjegjëse: Profesore Anna Tampaki

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Ruse dhe Studimeve Sllave

Përgjegjëse: Profesore Eleni Steriopulu

FAKULTETI I SHKENCAVE (<http://www.deansos.uoa.gr/>)

Dekan: Profesor Konstantinos Varotsos

Departamenti i Fizikës (<http://www.phys.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Nikolaos Tetrades

Departamenti i Kimisë (<http://www.chem.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Georgios-Isidoros Kokotos

Departamenti i Matematikës (<http://www.math.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Apostolos Burnetas

Departamenti i Biologjisë (<http://www.biol.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Kyriakos Georgiou

Departamenti i Gjeologjisë dhe Gjeokomunikacionit (<http://www.geol.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Nikolaos Vulgaris

Departamenti i Informatikës dhe Telekomunikacionit (<http://www.di.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Antonios Paschalis

Departamenti i Historisë dhe Filozofisë së Shkencës (<http://www.phs.uoa.gr/>)

Përgjegjës: Profesor Ioannis Hristianidhis



FAKULTETI I SHKENCAVE SHËNDETSORE

Dekan: Profesor Efstratios Patsuris

Departamenti i Mjekësisë (<http://www.med.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Petros Sifakis

Departamenti i Stomatologjisë (<http://www.dent.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor George Iliades

Departamenti i Farmacisë (<http://www.pharm.uoa.gr/>) - Përgjegjës: Profesor Panagiotis Marakos

Departamenti i Infermierisë (<http://www.nurs.uoa.gr/>) - Përgjegjëse: Profesore Hrisula Lemonidhu

FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT (<http://deanecd.uoa.gr/>)

Dekane: Profesore Thalia Dragona

Departamenti Pedagogjik i Arsimit Fillor (<http://www.primeedu.uoa.gr/>)


Përgjegjës: Profesor Thomas Babalis

Departamenti i Arsimit dhe Edukimit për Moshën Parashkollore (<http://www.ecd.uoa.gr/>)

Përgjegjëse: Profesore Thalia Dragona (ushtron detyrën e Përgjegjësës me vendim të Senatit)

FAKULTETI I EDUKATËS FIZIKE DHE SPORTIT (<http://www.phed.uoa.gr/>)

Dekan: Profesor Nikolaos Geladas



1. Vështrimi Historik

Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës u themelua me Dekretin Mbretëror të 22 prillit 1837 nën emrin “Universiteti i Othonit” për nder të Othonos, themelues dhe mbreti i parë i Greqisë së re.

Në fillim përfshinte katër Fakultete, Teologjik, Juridik, Mjekësor dhe “Fakultetin e Filozofisë dhe Udhëzimeve të tjera Arsimore”. Gjatë vitit të parë të funksionimit të tij Fondacioni kishte 33 pedagogë, ndërsa mësimet i ndiqnin 52 studentë dhe 75 ishin “dëgjues” të peregjistruar.

Fillimisht universiteti funksionoi në një ndërtesë neoklasike në shpatin verior të kodrës së Akropolit, e cila më parë ishte banesa e arkitektit Stamatis Kleantis dhe Eduard Schaubert (sot këtu strehohet Muzeu Historik i Universitetit). Ishte Universiteti i parë në shtetin grek të sapoformuar, si edhe në Ballkan dhe në rajonin e Mesdheut Lindor.



Roli i tij ishte vendimtar, si nga ana historike dhe nga pikëpamja sociale, për zhvillimin e potencialit shkencor të vendit, avancimin e dijes dhe promovimin e jetës kulturore në Greqi. I rëndësishëm ishte dhe prestigji i tij ndërkombëtar.

Në nëntor 1841 Universiteti u transferua në një ndërtesë të projektuar nga arkitekti danez Christian Hansen. Fasada e tij, e njohur si “Propilea”, u përfundua në 1842-1843. Ndërtesa, e zbuluar me veprat e piktorit Karl Rahl, është së bashku me ndërtesat e Bibliotekës Kombëtare të Greqisë dhe të Akademisë së Athinës, e njohur si “trilogjia arkitekturore” neo-klasike e Athinës. Sot, ky monument historik është ndërtesa e Administratës së Universitetit si dhe vend veprimtarish kulturore dhe festive të Universitetit. Në 1862 “Universiteti i Othonit” u riemërua “Universiteti Kombëtar”, pasi Mbreti Otto u detyrua të largohej nga vendi. Me ligjin Goke të 17 korrikut 1911, në bazë të testamentit të mirëbërësit Ioanni Dompoli, të lënë më 4 shkurt 1849, u themelua “Universiteti Kapodistrian”, i cili kishte Senat dhe Rektor të përbashkët me “Universitetin Kombëtar” i cili u bashkua me Fakultetin Teorik, Filozofik, Teologjik dhe Juridik, ndërsa Universiteti Kombëtar kishte fakultet e Mjekësisë dhe Fizikomatematikës dhe të Farmaceutikës. Që nga viti 1932 “Universiteti Kombëtar” dhe “Universiteti Kapodistrian” së bashku formojnë në bazë të nenit 1 të Ligjit. 5343/1932, “Universitetin Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës.”



Deri në fillim të shekullit 20, Universiteti i Athinës ishte i vetmi Universitet i Greqisë, i cili i jepte shoqërisë greke shkencëtarë të kualifikuar në mjekësi, në shkencat natyrore dhe sociale, juridike dhe financiare, në letërsi, histori, arkeologji , edukim si dhe në fetari.

Gjatë rrjedhës historike, shumë studentë dhe mësues kanë luajtur një rol kyç në fushat e zhvillimit shkencor, filozofisë, letërsisë, të tilla si George Papanikolau, Eleni Glikatzi- Arveler , Konstantin Karatheodhori, etj.. Ne jemi gjithashtu krenarë për Nobelistët e Letërsisë si Odisea Eliti dhe George Seferis, të cilët kanë studiuar në Universitetin e Athinës dhe Kazanzaqis Nikos, i cili për nëntë vjet me radhë u propozua si kandidat për çmimin Nobel në letërsi . Sekretar i Fondacionit ishte poeti ynë kombëtar Kostis Palamas.

Deri më sot, EKPA vazhdon të ofrojë shërbime të rëndësishme shkencore, kërkimore, arsimore dhe sociale. Indikativisht ne përmendim, një nga kontributet më të mëdha në drejtim të shëndetit kombëtar, të studentëve/ studenteve të Fakultetit të Shkencave Shëndetësore që bëjnë praktikën e tyre dhe ofrojnë shërbimet e tyre mjekësore për publikun nën mbikëqyrjen e pedagogëve.

Persona të rëndësishëm - doktoratura nderi

Që nga themelimi i Universitetit të EKPA-s, shumica e presidentëve grekë të Republikës, kryeministra, si dhe një numër i shquar i ministrave dhe gjykatësve të Gjykatave Supreme, shërbyen si studentë apo profesorë të Universitetit tonë. Që nga viti 1860, për të nderuar personalitete të shquara në fushën e shkencës, letërsisë dhe artit, një numri të konsiderueshëm personalitetesh u janë dhënë Doktorat e Nderit të EKPA-s.

Ndër të tjerët, fituesve të Çmimit Nobel në vijim, të cilëve u janë dhënë doktoratura nderi të Universitetit të Athinës:

- John Nash (Çmimi Nobel në Skencat Ekonomike)
- Edward Prescott (Çmimi Nobel në Skencat Ekonomike)
- Harry Markowitz (Çmimi Nobel në Skencat Ekonomike)
- Peter Agre (Çmimi Nobel në Kimi)
- Jean-Marie Lehn (Çmimi Nobel në Kimi)
- François Jacob (Çmimi Nobel në Fiziologji dhe Mjekësi)
- Luis J. Ignarro (Çmimi Nobel në Fiziologji dhe Mjekësi)
- Herald zur Hausen (Çmimi Nobel në Fiziologji dhe Mjekësi)
- Derek Walcott (Çmimi Nobel në Letërsi)
- Odisea Elitis (Çmimi Nobel në Letërsi)
- Joseph Sifakis (Turing Award, i konsideruar si “Nobel” i Informatikës)



Gjithashtu, personaliteteve ndërkombëtare që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e shkencës, u është dhënë titulli Doktoratë Nderi nga EKPA-s :

- Pierre Paul Émile Roux (1912)
- Charles Émile Picard (1937)
- Max Planck (1937)
- Sir Aleksandër Fleming (1946)
- George Papanikolaou (1949)
- Nicholas Negroponte (1999)
- Rudolph Emil Kalman (2003)



Doktorat e nderit të Universitetit të Athinës u janë dhënë gjithashtu personaliteteve ndërkombëtare nga fusha e Letërsisë dhe Arteve, si dhe personaliteteve politike dhe fetare, disa prej të cilëve janë renditur më poshtë:

Shkrimtarë / Eseistë / Filozofë / Shkrimtarë

- Joseph Rudyard Kipling (1924)
- Yannis Ritsos (1987)
- Umberto Eko (1995)
- Avram Noam Chomsky (2004)
- Peter Stein (2004)
- Margaret Atwood (2013)
- Eleni Glikatzi-Arveller (2014)

Personalitete politike (jashtë Greqisë)

- Léon Gambetta (1870)
- Georges Clemenceau (1912)
- Woodrow Wilson (1918)
- J. William Fulbright (1978)
- Jacques Delors (1992)
- Glafkos Klerides (1996)
- Roman Herzog (1997)
- Vladimir Putin (2001)
- Jacques Lang (2001)
- Giuliano Amato (2001)
- Vaclav Klaus (2006)
- Helmut Schmidt (2014)
- Ferenc Madl (2014)
- François Hollande (2015)
- Nikos Anastasiadis (2016)
- Pierre Moscovici (2017)



Personalitete fetare

Metropoliti i Athinës, Prokopios (1882)

Metropoliti i Rumanisë, Dragomir Dimitresku (1887)

Kryepeshkopi i Konstandinopojës, Romës së Re dhe Patriarku Ekumenik, Benjamin (1937)

Kryepeshkopi i Nea Justinian dhe gjithë Qipros, Makarios (1957)

Metropoliti i Zvicrës, Damask (1990)

Patriarku i Moskës dhe i gjithë Ruisë, Alexios B' (1992)

Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Anastasios (1998)

Kryepeshkopi i Konstandinopojës, Romës së Re dhe Patriarku Ekumenik, Bartolomeu (1999)

Kryepeshkopi i Amerikës Dhimitrios (2005)

Kryepeshkopi i Canterbury, Rowan Williams (2010)

Kryepeshkopi i Athinës dhe i gjithë Greqisë, Ieronymos II (2010)

Papa dhe Patriarku i Aleksandrisë dhe i gjithë Afrikës, Theodor B' (2012)

2. Studime, objekte dhe shërbime



2.1. Studime në Universitetin e Athinës

2.1.1. Studime universitare

Në tetë (8) Fakultetet e EKPA-s - Theologjik, Juridik, Ekonomik, Shkencave Politike, Filozofik, Shkencave Shëndetësore, Shkencave të Edukimit, Shkencave të Edukimit Fizik dhe Sporteve, funksionojnë tridhjetë e tre (33) departamente akademike. Çdo departament akademik siguron dhe zbaton një (1) program universitar, kështu që nga EKPA-s. jepen 33 diploma, të cilat janë emëruar nga departamenti dhe të cilat mbajnë emrin e departamenteve.

Numri i studentëve dhe procesi i pranimit të tyre në një departament, përcaktohet nga legjislacioni grek për hyrjen e nxënësve në institucionet publike të arsimit të lartë.

Planprogrami përfshin kurset kryesore të detyruara, të përzgjedhura dhe cikleve tematike, opsionale të detyruara, laboratore, seminare, studime rurale dhe klinike, praktika, diploma, etj, në mënyrë që studentët mund

të personalizojnë programin e tyre në bazë të prirjeve dhe interesave të tyre shkencore.

Struktura dhe përmbajtja e kurseve janë të përcaktuara nga Departamenti i Kurrikulës, i cili rishikohet çdo vit për të marrë parasysh tendencat e reja shkencore dhe arsimore, teknologjitë e reja dhe kërkesat e tregut të punës. Ekzistenca në Fondacion e një numri të konsiderueshëm laboratorësh, klinikash, muzeumesh, bibliotekash, sallash leximi, të institucionalizuara si dhe Qendra e Mësimdhënies së Gjuhëve të Huaja dhe Qendra e Mësimdhënies së Gjuhës Moderne Greke për studentët tanë të huaj, është e një rëndësie të veçantë për një nivel të lartë arsimor, sepse ato kontribuojnë si në procesin arsimor, ashtu edhe në kërkimin dhe ndërlidhjen me shoqërinë.

Koha minimale e studimit për marrjen e diplomës është tetë (8) semestra, me përjashtim të disa departamenteve që janë dhjetë (10) dhe Mjekësisë që është dymbëdhjetë (12). Çdo kurs mbart një numër ECTS si dhe një numër të Njërive Mësimore (DM), i cili merret parasysh në llogaritjen e Notës së Diplomës si një faktor koeficient. Diploma vërteton përfundimin me sukses të ciklit të parë dhe nota e saj kategorizohet si vijon: Shkëlqyer, nga tetë presje pesëdhjetë e një (8.51) deri në dhjetë (10), Shumë mirë, nga gjashtë e pesëdhjetë (6.50) deri në tetë e pesëdhjetë (8,50), Mirë, nga pesë (5) deri në gjashtë e dyzet e nëntë (6,49).

2.1.2. Studime pasuniversitare

Njëqind e tridhjetë e gjashtë (136) Programe Pasuniversitare (PU si më poshtë) - departamentale, ndërdepartamentale, ndërinstiucionore dhe ndërshtetërore - ofrohen nga EKPA.

Nga këto, katër (4) PU në vijim po bashkëpunojnë gjithashtu me Institute Kërkimore:

- PU: « Athens International Master's Programme in Neurosciences » - « Programi i Diplomës Ndërkombëtare të Magjistraturës në Neuroshkencë: në bashkëpunim me Institutin e Shkencave Biomedikale të Akademisë së Athinës, Institutin Helenik Pasteur, Qendrën Kërkimore të Shkencave Biologjike Alexandros Fleming, E.KE.F.E Demokritos (Ndërdepartamentale).
- PU “Microelektronik”: në bashkëpunim me Institutin e Nanoscience & Nanoteknologji, E.KE.F.E Demokritos (Interdepartamentale), Institutin e Komunikimit dhe sistemeve kompjuterike (ICCS) (Ndërdepartamentale).
- PU “Teknologjitë e informacionit në mjekësi dhe Biologji: në bashkëpunim me” Fondacionin e Kërkimeve Biomedikale të Akademisë së Athinës dhe Institutin e Informatikës dhe Telekomunikacionit, E.KE.F.E Demokritos (Ndërdepartamentale).
- PU “Fizikë Mjekësore - Radiofizikë”: në bashkëpunim me Komisionin grek të Energjisë Atomike (EEAE) dhe E.KE.F.E Demokritos (Ndërdepartamentale).



Programe Ndërkombëtare pasuniversitare

Me interes të veçantë janë programet ndërkombëtare pasuniversitare. Disa prej tyre (dhe Departamentet që i ofrojnë) janë:

- Master European në Kulturat Klasike (EMCC) një program ndërkombëtar evropian në studimet klasike me 11 universitete nga tetë vende evropiane (Departamenti i Historisë dhe Arkeologjisë).
- Master i përbashkët greko-francez: “E Drejta Publike e Specializuar” (Fakulteti Juridik dhe Universiteti Montesquieu-Bordeaux IV).
- Master i përbashkët greko-francez: “Mësimi i gjuhëve të huaja në Evropë” (Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Franceze dhe Universiteti Angers).
- Master i përbashkët në Arsimit dhe të Drejtat e Njeriut (Departamenti i Edukimit dhe Arsimit të Fëmijërisë së Hershme, University College London).
- Programi Ndërkombëtar “Programi i Masterit European për Shoqërinë, Shkencën dhe Teknologjinë” në të cilin marrin pjesë 13 Universitete (Departamenti i Historisë dhe Filozofisë së Shkencave).
- “Kirurgjia intravaskulare” (Departamenti i Mjekësisë dhe Universiteti i Milanos - Bicocca).
- “Neurofiziologji klinike” (Departamenti i Mjekësisë dhe Instituti Neurologjik i Montrealit të Universitetit McGill).
- “Mësimi dhe Metodologjia e Matematikës “ (Departamenti i Matematikës, Universiteti i Athinës, Departamenti i Filozofisë-Pedagogjisë-Psikologjisë, Universiteti i Athinës, Departamenti i Matematikës dhe i Statistikës, Universiteti i Qipros, Departamenti i Edukimit, Universiteti i Qipros).
- “Këshillimi dhe Udhëzimi i Shkollave” (Departamenti Pedagogjik i Arsimit Fillor, në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Universitetit të Qipros).

Programet pasuniversitare në anglisht:

- Programi pasuniversitar Anglisht-folës “Studime të Europës Juglindore” i Departamentit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike është themeluar në vitin 1999. Gjatë themelimit dhe në hapat e tij të parë bashkëpunoi me disa universitete, por në vazhdim u bë një program i pavarur Pasuniversitar i Universitetit të Athinës dhe që atëherë ka pranuar shumë studentë grekë dhe të huaj (nga 36 vende).

Përveç sa thamë më sipër, vërehet se gjatë vitit akademik 2017-18 është planifikuar të veprojnë tri (3) aoma programe pasuniversitare anglisht-folëse:

- Arkeologjia e Greqisë dhe e Mesdheut Lindor: që nga pallatet e Epokës së Bronzit të Mbretërive Helene - Master in Greek and Eastern Mediterranean Archaeology (<http://meditarch.arch.uoa.gr/site/meditarch>)
- Programi ndërkombëtar pasuniversitar në Neuroshkencë - Athens International Master’s Programme in Neurosciences (<http://masterneuroscience.biol.uoa.gr>).
- Master në Administrim Biznesi - Master in Business Administration Program, with specialization in Internal Audit (<http://www.ddomo-ia.econ.uoa.gr>).

Me interes të veçantë është fakti se EKPA-s ka protokolle të veçanta bashkëpunimi me 28 institucione ekuivalente jashtë vendit për redaktimin /përpunimin e disertacioneve/doktoraturave me bashkë-mbikëqyrje (Lista është në dispozicion në: http://www.uoa.gr/fileadmin/user_upload/ekpaideysh/spoydes/PhD_EidPrwtokollaSynergias012017.doc).

2.1.3.Hulumtimi i doktoraturës

Universiteti punëson dhe bashkëpunon me shkencëtarë që kryejnë kërkime shkencore pasdoktorale në fushat kërkimore të departamenteve të tyre. Bashkëpunimi i referohet në veçanti mbikëqyrjes ose mbështetjes, këshillimit të hulumtimit pasdoktoral nga një anëtar ose anëtarët e stafit mësimdhënës, ofrimin të qasjes në materialet shkencore apo pajisjet shkencore, ose caktimit nga Universiteti të një projekti të veçantë kërkimi me apo pa shpërblim.

2.1.4. Shkollat verore

Herë pas here “**shkolla verore**” organizohen në fusha të caktuara të interesit, të cilat janë të lidhura ngushtë me veçoritë e ofruara nga vendi ynë ose Universiteti dhe shumë studentë kanë shprehur një interes të veçantë për to. Japim si shembull, shkollën verore në Athinë, Maraton dhe Kea (Cyclades, Deti Egje) “Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore: Arkeologji, Arkitekturë dhe Planifikim Urban në vitin 2016”.



2.1.5. Nderime / Çmime për studentët

EKPA-s i inkurajon studentët e tij universitarë dhe pasuniversitarë që të marrin pjesë në konkurse ndërkombëtare dhe ngjarje shkencore që lidhen me temën e studimeve të tyre. Grupe studentësh, nën drejtimin e profesorëve të tyre, janë dalluar dhe kanë shkëlqyer në konkurse ndërkombëtare dhe Olimpiada. Përmendim disa shembuj të kohëve të fundit të dhënies së çmimeve për studentët e EKPA- s:

- Çmime të Studentëve Pasuniversitarë të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Konferencën Ndërkombëtare “Miti dhe Emocioni” në Universitetin Complutense të Madridit (2017).
- Grupi i studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës, i cili së fundmi (2017) ka marrë pjesë në Turin European të konkursit universitar ndërkombëtar të gjykimit virtual, ELSA Moot Court Competition on World Trade Organization Law (EMC2) fitoi Çmimin për Memorandumin më të mirë për të pandehurin (Çmimin për Parashtresën më të Mirë me Shkrim për të Paditurin) (Award for Best Written Submission Respondent) dhe Çmimin për Dorëzimin me Shkrim më të mirë në përgjithësi (Award for Best Written Submission Overall).
- Kampion evropian për dy vjet rresht (2016, 2015), një grup studentësh të Fakultetit Juridik në Konkursin Ndërkombëtar të Gjykatës Virtuale për Ligjin e Hapësirës (Manfred Lachs Space Law Moot Court Competition).
- Dallim i Fakultetit Juridik në Konkursin e Arbitrazhit Virtual të Tregtisë Ndërkombëtare (International Commercial Arbitration Moot 2016).
- Tri (3) medalje u fituan nga grupi i studentëve të Departamentit të Matematikës në konkursin matematik SEEMOUS (South-Eastern European Mathematics Olympiad for University Students) to 2017.

Pesë (5) medalje (1 ar, 2 argjend dhe 2 bronz) fitoi grupi pesë-anëtarësh i Departamentit të Matematikës në Konkursin e Studentëve IMC 2016.

- Medalja e Artë për EKPA-n në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës SEEMOUS 2016 (South-Eastern European Mathematics Olympiad for University Students). Dallim i një studenti pasuniversitar të Departamentit të Historisë dhe Arkeologjisë në konkursin ndërkombëtar të eseve «Peace and Security in the 21st Century - a Youth Perspective for Achieving It», e organizuar nga Public Policy Division të NATO (2016).
- Dallimi (vendi i parë) i studentëve të Departamentit të Informatikës dhe Telekomunikacionit në konkursin për inovacion NBG i-bank #fintech crowdhackathon (2016).

2.2. Objektet dhe shërbimet e ofruara

Infrastruktura e ndërtesave të Universitetit, me një sipërfaqe totale prej 700,000 m². përafërsisht, të cilat përdoren për arsimim, hulumtim dhe menaxhim, përmbledhin katër kampuset me fakultetet e tyre, në Zografu (Filozofi, Shkencat Ekzakte, Teologji), në Gudi (Shkencat Shëndetësore), në qendër të Athinës (Juridik, Shkencat Ekonomike dhe Politike, Shkencat e Edukimit) dhe në Dafni (Shkencat e Edukimit Fizik). Në ndërtimin e komplekseve të Fakulteteve veprojnë salla mësimore, të madhësive të ndryshme, me pajisje moderne vizuale dhe infrastruktura IT, laboratorë arsimor dhe kërkimor të mirë-pajisur dhe infrastruktura të tjera mbështetëse.

Universiteti gjithashtu ofron një sërë objektivash dhe shërbimesh për të mbështetur studentët universitar dhe pasuniversitar. Indikativisht, disa janë të listuara në tabelën më poshtë.

| Shërbime konsultuese | Shërbime mbështetëse | Objektet e studimit dhe argëtimit |
|--|--|---|
| Avokati i Studentit | Njësia e aksesit të Studentët me Aftësi të Kufizuara | 8 ndërtesa (në fakultete) Bibliotekat e Universitetit 2 Biblioteka të Klubit të Universitetit Sallat e leximit |
| Njësia e Ndërhyrjes Psikosociale | Fondi Studentor i Ndihmës | Qendra kompjuterike |
| Zyra e Këshillimit fakulteti Teologjik | Qyteti i Studentit | Zyra Multimedia për Shërbimin e Studentëve |
| Zyra Këshillëdhënëse për Arsimin Fillor | Shërbimet e Ushqimit | Qendra e Mësimi të Gjuhëve të Huaja |
| Njësia e Higjienës së Komunitetit | Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor | Qendra e Mësimi të Gjuhës Greke Moderne |
| Qendra e Këshillimit të bashkëmohatarëve | Bursa - Çmime | Bursa - Çmime Palestra e Universitetit dhe qendra sportive |
| | | Klubi Kulturor i Studentëve |



Qendra /Kursi për mësimin e gjuhës greke (<http://www.greekcourses.uoa.gr>)

Qendra për mësimin e gjuhës greke si gjuhë e dytë /e huaj në EKPA-s funksionon nga viti 1950, fillimisht me një numër të vogël studentësh, numër i cili në dekadat që pasuan është rritur ndjeshëm. Qendra për mësimin e greqishtes është qendra më e madhe mësimore e gjuhës greke në botë. Shumë prej të diplomuarve janë tani profesorë të Gjuhës dhe Filologjisë Greke në të gjithë botën, anëtarë të trupit diplomatik të vendeve të tyre, anëtarë të hierarkisë kishtarë, shkencëtarë të shquar, menaxherë, artistë dhe biznesmenë të shquar.

Qendra /Kursi i përket Programit Ndërdepartamental për mësimdhënien e Gjuhës Greke si gjuhë e dytë / të huaj së bashku me pasuniversitarin më të njëjtin titull Program i Studimeve pasuniversitare të Departamentit të Filologjisë dhe Departamentit të Filozofisë, Pedagogjisë dhe Psikologjisë.

Objektivat e Kursit janë:

- Mësimi i Gjuhës Greke si gjuhë e dytë / e huaj
- Çertifikimi i shkallës së njohurive së Gjuhës Greke si gjuhë e dytë / e huaj
- Kontakti i studentëve të huaj me fusha dhe tema të kulturës greke
- Trajnimi praktik i studentëve të programit pasuniversitar për mësimin e Gjuhës Greke si gjuhë e dytë / e huaj

Në Qendrën e mësimin të Gjuhës Greke, çdo muaj organizohen vizita në muze dhe zona arkeologjike, si dhe ekskursione në zona me interes historik (Sounio, Delphi, Mikenë, Epidavros, Nafplio). Vizitat turistike marrin formën e kurseve në bazë të nivelit të studentëve (fillestar, i ndërmjetëm, i përparuar). Studentët përgatiten për këto ekskursione, të cilat janë pjesë e kurrikulës kryesore, me materiale të shtypura dhe piktoriale, ushtrime leksikore, referenca historike dhe debate në klasë.



Qendra e mësimit të gjuhëve të huaja (<http://www.didaskaleio.uoa.gr>)

Qendra e mësimit të Gjuhëve të Huaja, u themelua në vitin 1931 dhe ishte fillimisht Departamenti i Klubit të Universitetit. Që në fillim qëllimi i saj ishte mësimi i gjuhëve të huaja, i cili për vite ishte kufizuar në mësimin e gjuhëve gjerësisht të folura, anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht, me të cilat u bashkuan më vonë spanjishtja dhe rusishtja. Me vendim të Senatit të Universitetit, të vitin 1994, Qendra e mësimit të Gjuhëve të huaja bëhet një qendër plotësisht e pavarur dhe një njësi e pavarur akademike.

Sot mësohen 23 gjuhë në të gjitha nivelet: Anglisht, Shqip, Arabisht, Bullgarisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Danisht, Japonisht, Indisht (Hindi-Sanskrit), Spanjisht, Italisht, Kinezisht, Koreanisht, Norvegjisht, Holandisht, Persisht, Portugalisht, Ruisht, Serbisht, Suedisht, Turqisht, Çekisht dhe Finlandisht. Përveç kësaj, programe të veçanta janë në dispozicion për këdo që dëshiron të specializohet në përkthimin e gjuhës, në shkencat juridike ose shkencat mjekësore.

Muzeume



Muzeu i Historisë së Universitetit të Athinës

